

“DEGA RENCO SPA ALBANIA”- Degë e shoqërisë së huaj

Pasqyrat Financiare

Për ushtrimin e mbyllur më
31 Dhjetor 2021

NUIS L61424037V
Autostrada Tiranë-Durrës, Km 2, Tiranë

PËRMBAJTJA:

Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e performancës	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	6
1. Informacion i përgjithshëm	7
2. Bazat e pëgatitjes së Pasqyrave Financiare	7
3. Politikat kontabël	8
5. Mjete monetare	13
6. Llogari të arkëtueshme tregtare	13
7. Kërkesa të arkëtueshme nga palët e lidhura	14
8. Të tjera llogari të arkëtueshme	14
9. Inventari	14
10. Aktivitet afatgjatë materiale	14
11. Llogari të pagueshme tregtare	15
12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15
13. Detyrime tatimore	15
14. Të ardhura të shtyra	15
15. Të tjera detyrime	16
16. Të tjera detyrime afatgjatë	16
17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16
18. Lënde e parë materiale të konsumueshme dhe të tjera shërbime	16
19. Shpenzime për personelin	17
20. Kosto e aseteve të shitura	18
21. (Shpenzime)/të ardhura financiare neto	18
22. Tatimi mbi fitimin	18
23. Angazhime dhe pasiguri	19
24. Ngjarje pas dates së bilancit	19

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
 Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat në leke)


Pasqyra e pozicionit financiar	Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Aktivet Afatshkurtra			
Mjete monetare	5	47,931,442	3,661,858
Llogari të arkëtueshme tregtare	6	43,634,402	95,398,886
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	7	84,710,968	23,625,254
Të tjera llogari të arkëtueshme	8	1,354,225	38,483,798
Inventar	9	-	-
Total Aktive afatshkurtra		177,631,037	161,169,796
Aktivet Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	8,239,616	6,999,964
Aktivet afatgjata jomateriale		122,401	144,001
Totali për Aktivet Afatgjata		8,362,017	7,143,964
Totali i Aktiveve		185,993,054	168,313,760
DETYRIMET			
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	32,470,891	11,166,975
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	148,428,586	110,186,383
Detyrimet tatimore	13	983,105	5,035,786
Të ardhura të shtyra	14	-	-
Të tjera detyrime	15	6,187,777	3,682,414
Totali per Detyrimet Afatshkurtra		188,070,358	130,071,557
Detyrimet Afatgjata			
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura			
Të tjera detyrime	16	-	0
Totali per Detyrimet Afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		188,070,358	130,071,557
KAPITALI aksionar			
Kapitali i nënshkruar			-
Rezerva ligjore			
Rezerva te tjera			
Fitimet e pashperndara			
Fitimi/Humbja e vitit financiar		(2,077,304)	38,242,203
Totali per Kapitalin		(2,077,304)	38,242,203
Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit		185,993,054	168,313,760

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021, u aprovuan me 31.03.2022 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Administratori

Valerio Mario Capozzella

CAPOZZELLA
 VALERIO M



“Dega Renco SPA Albania-Dege e Shoqerise se huaj”
PASQYRA E PERFORMANCËS (Të ardhura shpenzime)
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat ne leke)

Pasqyra e performancës
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)
Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas Natyrës

Të Ardhura & Shpenzime	Note	Për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
01/01/2021-31/12/2021			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	Note 17	126,932,000	98,377,940
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		8,612,185	28,153,048
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		(116,184,011)	(38,346,686)
1) Lënde e parë dhe materiale të konsumueshme	Note 18	(15,877,068)	(8,587,792)
2) Punime nga të Tretët		(77,759,046)	(12,283,742)
3) Të tjera shpenzime		(22,547,897)	(17,475,152)
Shpenzime të personelit	Note 19	(16,154,632)	(15,914,923)
1) Paga e personelit		(13,960,986)	(13,784,185)
2) Shpenzime të Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(2,193,646)	(2,130,738)
Shpenzime konsumi dhe Amortizimi		(1,666,287)	(3,256,842)
Kosto e Aseteve të Shitura	Note 20	-	(24,302,738)
Shpenzime financiare	Note 21	(2,367,377)	989,800
1) Shpenzime Interesa dhe shpenzime të ngjashme		-	-
2) Shpenzime të tjera financiare		(2,367,377)	989,800
Fitimi(humbja) para tatimit		(828,122)	45,699,600
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	Note 22	(1,249,182)	(7,457,397)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		(2,077,304)	38,242,203
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin			

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021, u aprovuan me 31.03.2022 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Administratori

Valerio Mario Capozzella

CAPOZZELLA
 VALERIO M

“Dega Renco SPA Albania-Dege e Shoqerise se huaj”
 PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO
 Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat ne leke)

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto
 Për Vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019		-		-	
Fitimi / Humbja e vitit				23,930,260	23,930,260
Levizje permes kapitalit					
Dividendë të paguar					
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019		-		23,930,260	23,930,260
Fitimi / Humbja e vitit				38,242,203	38,242,203
Levizje permes kapitalit					
Dividendë të paguar					
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020		-		38,242,203	38,242,203
Fitimi / Humbja e vitit				-2,077,304	-2,077,304
Levizje permes kapitalit					
Dividendë të paguar					
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021		-		-2,077,304	-2,077,304

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021, u aprovuan me 31.03.2022 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Administratori

Valerio Mario Capozzella

CAPOZZELLA
 VALERIO M.

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”
PASQYRA E LËVIZJES SË FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE (CASH FLOW)
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat në leke)

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare
 Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	-2,077,304	38,242,203
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	1,666,287	3,256,842
<i>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	27,808,343	10,001,673
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	19,756,598	-49,488,802
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	47,153,923	2,011,916
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit		
<i>a. Para të përdorura për blerjen e filialeve</i>		
<i>b. Para të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
<i>c. Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	-2,884,339	-291,667
<i>d. Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e investimit	-2,884,339	-291,667
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e financimit	0	0
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	44,269,584	1,720,249
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	3,661,858	1,941,609
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	47,931,442	3,661,858

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021, u aprovuan më 31.03.2022 dhe u nënshkrua si më poshtë:

Administratori

Valerio Mario Capozzella

CAPOZZELLA
VALERIO M

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria “DEGA RENCO SPA ALBANIA”, është themeluar prane QKB më date 24/02/2016. Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj aktualisht në Tiranë, Adresa: Autostrada Tirane -Durres, Km 2, objekt me numer pasurie 40/32, zona kadastrale 2679.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë përfshin : “Përgatitja e projekteve të vlerës maksimale dhe ekzekutiv, planet e investimeve, financiare, ekonomike, etj., - Të hartojë specifikimet e tenderit; - Studimi, projektimin, ndërtimin, zbatimin dhe shpërndarjen e inxhinierisë komplekse impianti, industriale, objekteve industriale, rezidenciale, komerciale, turistike, social, etj, e punëve me interes publik, se çdo gjë që mund të jetë objekt i aplikimit në , planifikimi industriale dhe civile urban, arkitekturës dhe inxhinierisë; -Sjellja, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e drejtpërdrejtë ose nën mbikëqyrje të saj dhe ndihmë për platformave të naftës,gazit, ujit, industriale dhe civilëve në përgjithësi; -Menaxhimi i plotë i rrjeteve të shpërndarjes së gazit për çdo përdorim, duke përfshirë komercializimin dhe shitjen e vetë gazrave; - Këshillimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi për të gjitha punët ose ndërtimit të përmendura më lart; - Ofrimi i shërbimeve të cilat, në çdo formë potra 'të nevojshme për të përfunduar punimet e listuara më sipër; - Kryerja e një hulumtimi social-ekonomike dhe të tregut të nevojshme për realizimin e iniciativave dhe punimeve në kuadër të qëllimeve sociale; - Zhvillimi i studimeve të plotë të fizibilitetit; - Promovimi marrëveshje me institucione, institucionet italiane dhe të huaja, kushtetutat e kompanive, ndërmarrjeve, konsorciumet; - Run, gjithashtu kontraktori si të përgjithshme, dhe të angazhohen punimet nën drejtimin e saj përmbarimi; - Të marrë me qira ose të japë përfaqësime në lidhje me aktivitete të ngjashme dhe të ngjashme me ato të parashikuara në këtë nen; - Dhënia e garancive dhe hipotekve qe është në interesin e saj që në favor të tretë, të marrë në hipotekat aktive dhe pasive; - Kryerja e transportit për palët e treta”. Shoqëria ushtron aktivitetin dhe në Fier Topoje me koordinata 019 27'08' E:40 47'34" N|long/lat: WGS84 (kantier).

Shoqëria është regjistruar pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj,Tirane me NUIS L61424037V .

Shoqëria është Degë e Shoqërisë së Huaj Renco SPA.

Administrator i shoqërisë është z. Valerio Mario Capozzella

Numri i punonjesve me Dt 31.12.2021 është 13 dhe më Dt.31.12.2020 : 12

2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të Permiresuara, të cilat përbëhen nga regullat dhe interpretimet në përputhje me Ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ne baze të urdhrin Nr.64 date 22.07.2014 “Per shpalljen e standarteve kombetare të kontabilitetit të permiresuara dhe zbatimin e detyrueshem të tyre”. Ministria e Financave vendosi të bejë të detyrueshem zbatimin e Standarteve Kombetare të Kontabilitetit të Permiresuara duke filluar nga 1 Janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me publikimin në fletoren Zyrtare Nr.119, date 01.08.2014

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Shenimet shoqeruese janë pjese perberse e ketyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK, monedhën shqiptare, e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
Eur/LEK	120.76	123.70
USD/ LEK	106.54	100.84

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to maten mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Inventari

Inventarët rregjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kostopërfshihet edhe pjesa respective e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rendesishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditorit.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyresh dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%

iv. *Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjestim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të

minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirase operative njihen në pasqyrën e performancës me metoden lineare përgjate periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjate periudhës së qirasë.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periud hën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 akoma po evoluon në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

5. Mjete monetare

Arka, banka dhe likuiditete të tjera janë likuiditete në monedhë vendi dhe të huaj me 31 dhjetor 2021 , 2020 janë si më poshtë

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Llogari ne leke	47,566,719	2,935,511
Llogari ne monedhe te huaj	342,407	712,360
Arka	22,317	2,260
Arka	-	11,727
	47,931,442	3,661,858

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Kërkesa të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021, 2020 janë si me poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Kliente	43,634,402	95,398,886
Fatura për tu emetuar	-	-
	43,634,402	95,398,886

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”
Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

7. Kërkesa të arketueshme nga palët e lidhura

Llogari të arketueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Të tjere Debitor/ Kreditor RENCO SPA	84,710,968	23,625,254
	84,710,968	23,625,254

8. Të tjera llogari të arketueshme

Të tjera llogari të arketueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Parapagime Tatim fitimi	1,215,165	
TVSH e rimbursueshme	2,333	38,482,440
Taksë Doganore e TVSH në Doganë	6,519	1,358
Garanci	130,208	-
	1,354,225	38,483,798

9. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Inventari	-	-
Totali	-	-

10. Aktivët afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale dhe lëvizjet e tyre deri më 31 dhjetor 2021, 2020 paraqiten si më poshtë:

Kosto AAM					
1 Janar 2020	47,632,116	4,428,600	1,719,663	529,558	54,309,937
Shtesa		291,667			291,667
Pakesime/Axhustime	24,280,786	7,283	5,487		24,293,556
31 Dhjetor 2020	23,351,330	4,712,984	1,714,176	529,558	30,308,048
Kosto AAM					
1 Janar 2021	23,351,330	4,712,984	1,714,176	529,558	30,308,048
Shtesa	2,776,471	74,535	33,333		2,884,339
Pakesime/Axhustime					
31 Dhjetor 2021	26,127,801	4,787,519	1,747,509	529,558	33,192,387

Amortizimi

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”
 Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

1 Janar 2020	16,853,260	2,299,838	696,133	229,042	20,078,274
Amortizimi vjetor	2,378,157	586,843	204,706	60,104	3,229,810
Rimarje amortizimi					
31 Dhjetor 2020	19,231,417	2,886,681	900,839	289,146	23,308,084
Amortizimi					
1 Janar 2021	19,231,417	2,886,681	900,839	289,146	23,308,084
Amortizimi vjetor	973,145	459,681	163,779	48,083	1,644,687
Rimarje amortizimi					
31 Dhjetor 2021	20,204,562	3,346,362	1,064,618	337,229	24,952,771
Vlera Neto 31 Dhjetor 2020	4,119,913	1,826,303	813,337	240,412	6,999,964
Vlera Neto 31 Dhjetor 2021	5,923,240	1,441,156	682,892	192,329	8,239,616

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021, 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Furnitore	32,470,891	11,166,975
	-	
	32,470,891	11,166,975

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Te tjera detyrime	148,428,586	110,186,383
Fatura per tu marre Furnitore Lokale		
	148,428,586	110,186,383

13. Detyrime tatimore

Detyrime tatimore me 31 dhjetor 2021, 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Detyrime për sigurime shoqërore dhe TAP	296,699	218,199
Tatim në burim	25,606	15,294
TVSH e pagueshme	660,800	
Tatim fitimi		4,802,293
	983,105	5,035,786

14. Të ardhura të shtyra

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”
 Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Të ardhura të shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë:

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Te ardhura te shtyra	-	-
Totali	-	-

15. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë:

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Paga	6,187,777	3,682,414
Detyrime te Tjera	-	-
	6,187,777	3,682,414

16. Të tjera detyrime afatgjata

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Të tjera detyrime	-	-
Fatura per tu marre nga furnitore lokale	-	-
Totali	-	-

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020</u>
Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	126,932,000	98,377,940
Të Ardhura te tjera	8,612,185	28,153,048
	135,544,185	126,530,988

18. Lënde e parë materiale të konsumueshme dhe të tjera shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020</u>
Materiale per objektin TAP nga Renco SPA	-	616,324
Blerje Beton	-	3,939
Punime sipas situacionit	74,008,656	11,499,280
Materiale te tjera pune	2,326,822	3,108,834
Blerje Materiale Mallra per Proceset Kryesore	6,153	-
Sherbime nga te tretet	3,750,390	784,463

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërisë së huaj”

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Sherbime Agjensie Doganore	41,671	84,969
Sherbime laboratori test betoni	44,330	8,609
Punime me vinc	2,711,890	-
Sherbime Rada Oil	10,462,296	3,789,411
Shpenzime nafte	249,068	839,383
Takse Doganore	18,376	70,816
Tarife Skanimi	16,463	65,507
	93,636,114	20,871,534

Të tjera shpenzime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Shpenzime Energji	354,979	308,014
Blerje/Shpenzime te Tjera	202,990	-
Sherbime noteriale	343,250	414,667
Sherbime ligjore dhe fiskale	2,012,628	2,132,581
Sherbim Roje Civile	2,620,833	5,049,999
Sherbime Perktimi	528,400	-
Rimborso per messa a disposizione di postazioni di lavoro	162,647	-
Makina me qera	2,250,818	2,493,981
Shpenzime Qera Xh&E	1,039,829	1,106,151
Qira per te trete	1,909,176	728,240
Mirembajtje dhe riparime	618,024	764,219
Siguracione	125,500	-
Shpenzime te tjera	10,670	-
Shpenzime Kancelari	222,651	64,042
Shpenzime Udhetimi	1,448,687	292,137
Shpenzime Celular, POSTE	83,102	116,667
Transporte per blerje	5,471	-
Publicitet Reklama	216,464	-
Sherbime bankare	154,908	172,538
Taksa dhe tarifa vendore	249,125	350,616
Shpenzime te tjera per personelin	610,869	221,471
Shpenzime Pritje Percjellje dhe Dieta	3,163,442	2,358,361
Gjoha nga Kontrolli I TVSH	3,721,974	404,296
Shpenzime te pa njohura	491,462	426,395
	22,547,897	17,475,152

19. Shpenzime për personelin

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”
 Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Pagat e personelit	13,960,986	13,784,185
Sigururime shoqerore	2,193,646	2,130,738
	16,154,632	15,914,923

20. Kosto e asetëve të shitura

Kosto e asetëve të shitura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Kosto asetëve të shitura	-	-
Totali	-	-

21. (Shpenzime)/të ardhura financiare neto

(Shpenzime)/të ardhura financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesi dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Te ardhura nga interesat e fituara nga depozitat		-
Shpenzime për interesa	-	-
Te ardhura financiare		-
Te tjera shpenzime bankare		-
Humbja neto nga këmbimet valutore		989,800
Shpenzime financiare		989,800
Shpenzime financiare neto		(989,800)
Fitime nga këmbimet valutore	15,906	1,286,921
Humbje nga këmbimet valutore	-	297,121
Humbja neto nga këmbimet valutore	(2,367,377)	989,800
Fitime nga këmbimet valutore		

22. Tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet më poshtë:

“Dega Renco SPA Albania-Degë e Shoqërise së huaj”
 Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Humbje e mbartur		
Fitimi (Humbja) perpara tatimit	(828,122)	45,699,600
Shpenzime te pazbritshme per efekt tatim fitimi	9,156,002	4,016,382
Fitim i tatueshëm	8,327,880	49,715,982
Tatimi mbi fitimin (15%)	1,249,182	7,457,397

Shpenzime të pazbritshme

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Shpenzime Energji	354,979	308,014
Shpenzime Uje		
Shpenzime Qera Xh&E	1,370,829	1,106,151
Qira per te trete	654,915	728,240
Shpenzime te tjera per personelin		
Blere kafe+Uje+Ushqim Punonjesit		
Shpenzime Hotel+Restorant	2,561,844	1,043,286
Shpenzime te pa njohura	4,213,436	830,691
Diferenca nga Donacionet		
	9,156,002	4,016,382

23. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treat. Bazuar ne opinionin e drejtuesve te Shoqerise, konkluzioni perfundimtar ne lidhje me keto ceshtje nuk do te kete efekte negative ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Me 31 Dhjetor 2021 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

24. Ngjarje pas dates se bilancit

Nuk ka asnje ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021, u aprovuan me 31.03.2022 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Administratori

Valerio Mario Capozzella

CAPOZZELLA
VALERIO M

